

KËRKESË
Nr.810/1, datë 21.1.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, për pasurinë e paluajtshme pronë private, që preket nga projekti “Sistemim rrugësh, blloku Goricë”, bashkia Pogradec.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është bashkia Pogradec.

Me anë të këtij publikimi kërkohet që të vihen në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM nr.89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Refruar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, personat e tretë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e plotësimit të afateve të publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 482,586 (katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË
SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI:

“Sistemim rrugësh, blloku Goricë”, bashkia Pogradec
Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr.89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër, atësi mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Adrian Shaban Haxhillari	8582	14/68	Truall	m ²	46	10491	482,586	Certifikatë pronësie
Shuma totale e shpronësimit						46		482,586	